



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.05.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-1239/15, për z. Jeton Neziraj - Kryetar i Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar dhe Kushtrim Koliqi – Anëtar i Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi për z. Jeton Neziraj - Kryetar i Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar dhe Kushtrim Koliqi – Anëtar i Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar, me nr. AKK – 03-02-1239/15, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rasti është hapur bazuar në informacionet që ka paraqitur denoncuesi i rastit, sipas të cilave, z. Jeton Neziraj, krahas funksionit publik të Kryetarit të Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar, me anë të Qendrës “Multimedia”, vite me radhë, merr pjesë të buxhetit nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS). Po ashtu edhe z. Kushtrim Koliqi, krahas funksionit të Anëtarit të Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar, përmes Organizatës Joqeveritare “Integra”, merr qindra mijëra euro nga MKRS.

Mirëpo, gjatë trajtimit të rastit, analizimit të bazës ligjore dhe takimit që kanë pasur zyrtarët e AKK-së me z. Neziraj dhe z. Koliqi, është vlerësuar se kjo situatë nuk paraqet konflikt interesi. Kjo për faktin se Teatri Kombëtar i Kosovës, respektivisht Këshilli Drejtues, nuk i ndanë mjetet për financimin e këtyre organizatave, por këto mjete ndahen nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (neni 19, pika 3 e Ligjit nr. 04/L-106 për Teatrot).

Situatë tjetër për të cilën është dyshuar për konflikt (rast për rast) të interesit është realizimi i tri shfaqjeve nga z. Neziraj në Teatrin Kombëtar të Kosovës, përmes Qendrës “Multimedia”.

Në bazë të informacioneve të siguruara nga denoncuesit e rastit janë realizuar shfaqjet: “Fluturimi mbi teatrin e Kosovës”, “Romeo e Zhulieta” dhe “Lufta në kohën e dashurisë”. Këtë e ka pranuar edhe z. Neziraj në takimin që është organizuar në zyrat e AKK-së.

Në këtë situatë nuk ekziston konflikt “rast për rast” i interesit sepse për shfaqjet të cilat realizohen në teatër nuk vendosë Këshilli Drejtues i Teatrit. Bazuar në Ligjin për Teatrot (neni 14), realizimin e shfaqjeve mysafire në teatër e lejon Drejtori i përgjithshëm i Teatrit.

Andaj, konform nenit 18 (pika 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, duke marrë parasysh të gjitha faktet që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka konflikt interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

